

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6688
E enjte, 25 gusht 2022
çmimi 0.40 €

Miratohet rregullorja
për financimin e
dërgimit të FSK-së
jashtë vendit | **FAQE 6**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA FOLUR TË MËRKURËN PËR TAKIMIN E FUNDIT QË KA PASUR NË BRUKSEL ME PRESIDENTIN SERB ALEKSANDËR VUÇIQ | **FAQE 4-5**


KURTI: SERBIA NUK ËSHTË E INTERESUAR PËR NORMALIZIM TË PLOTË



Kryeministri Albin Kurti ka thënë se në takimin e fundit në Bruksel në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi pala tjetër ka nxjerrë vetëm konstatimin se nuk është e interesuar për normalizim të plotë, por për hapa të vegjël e gradualë. "Ne ishim të hapur për diskutime në këtë drejtim, mirëpo nga ndërtesa ka

dalë pala tjetër", ka thënë Kurti, duke përsëritur se autoritetet e Kosovës nuk do ta pranojnë rikthimin në qarkullim të targave KS për veturat brenda territorit të Kosovës si dhe do të zbatojnë masa reciproke për qytetarët e Serbisë sa i përket dokumentit për hyrje-dalje

AKTUALE



SHBA-ja, NDIHMË TË RE PËR
UKRAINËN RRETH 3 MILIARDË
DOLLARË | **F. 2**

MARRËVESHJA NË MES TË KOSOVËS
DHE DANIMARKËS PËR 300 QELI
BURGU, NË PROCES TË FINALIZIMIT | **F. 6**

GAP-I: PRODHIMI I ENERGISJË
ELEKTRIKE NUK PO I MBULON
KËRKESAT E KONSUMATORËVE | **F. 8**

EKONOMI



FILLON INSTALIMI I NJEHSORËVE TË
"TERMOKOS"-IT | **F. 8**

QEVERIA NDAN 41 MILIONË EURO
MBËSHETJE PËR QYTETARËT PËR
TEJKALIMIN E KRIZËS ENERGETIKE | **F. 8**

SPORT



BALLKANI SYNON KUALIFIKIMIN NË
FAZËN E GRUPEVE | **F. 10**



Nga ambasadori i ShBA-së në Kosovë, JEFFREY M. HOVENIE

GJASHTË MUAJ
TË REZISTENCËS,
QËNDRUESHMËRISË
DHE VENDOSMËRISË
SË UKRAINËS | **FAQE 7**



RAMA NË AUSTRI: QYTETARËT
E KOSOVËS NËN REGJIMIN
BARBAR LËVIZNIN LIRSHËM,
ME ÇLIRIMTARËT JANË PENG | **FAQE 7**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mbr: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Në 31-vjetorin e pavarësisë, Zelensky zotohet se Ukraina do ta luftojë Rusinë “deri në fund”



KIEV, 24 GUSHT - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky është zotuar se shteti i tij do t'i luftojë trupat ushtarake ruse “deri në fund”.

Ukraina shënon të mërkurën 31-vjetorin e pavarësisë nga ish-Bashkimi Sovjetik.

Po këtë ditë bëhen gjashtë muaj prej kur Rusia ka nisur sulmin e paprovokuar ndaj Ukrainës. “Përgjatë këtyre gjashtë muajve ne kemi ndryshuar historinë, kemi ndryshuar botën dhe kemi

ndryshuar veten... ne kemi nisur ta respektojmë veten. Ne e kuptojmë se, pavarësisht ndihmës dhe mbështetjes, askush përveç neve nuk do të luftojë për pavarësinë tonë. Ne jemi të bashkuar”, ka thënë Zelensky në adresimin e tij më 24 gusht. “Nuk ka rëndësi se çfarë ushtrie kemi. E rëndësishme është toka jonë. Ne do të luftojmë për të deri në fund”, ka thënë ai. Ukrainasit, dhe pjesa tjetër e botës, janë të përgatitur për një

luftë të gjatë.

Burimet perëndimore ushtarake kanë thënë se forcat ruse janë duke bërë përparim në territoret lindore dhe jugore të Ukrainës. Prej shpërthimit të luftës, shtatë milionë njerëz kanë ikur nga Ukraina, derisa kombet perëndimore kanë vendosur sanksione financiare dhe teknologjike ndaj Rusisë për agresionin.

Zelensky, 44-vjeçar, e ka pranuar ndikimin e rëndë të luftës në

Ukrainë. “Çdo ditë është një arsye e re për t'u mos dorëzuar. Sepse, meqë kemi bërë kaq shumë, ne kemi çdo të drejtë të shkojmë deri në fund. Çka është fundi i luftës për ne? Ne kemi thënë dikur: paqja. Tani themi: fitorja”, ka thënë ai, duke shtuar se lufta nuk do të përfundojë derisa e gjitha Ukraina, përfshirë rajonet separatiste në lindje dhe Krimeja e aneksuar nga Moskë më 2014, të jenë nën kontrollin e Kievit. “Ne do t'i çojmë duart lart vetëm

një herë - kur ta festojmë fitoren e gjithë Ukrainës. Sepse ne nuk tregtojmë tokën dhe popullin tonë”, ka thënë ai.

“Për ne Ukraina është e gjithë Ukraina. Të gjitha 25 rajonet, pa koncesione apo kompromise. Ne nuk njohim këto fjalë, se ato janë shkatërruar nga raketat më 24 shkurt”, shtoi Zelensky.

Kryeqyteti ukrainas, Kiev dhe disa qytete të tjera të mëdha, kanë ndaluar festimet publike, pas paralajmërimeve se Rusia mund të përdorë këtë ngjarje për ta sulmuar infrastrukturën civile dhe qeveritare.

Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, u ka thënë banorëve që të jenë vigjilentë teksa festojnë, pasi përvjetori i pavarësisë përkon me gjashtëmuajorin e nisjes së luftës. “Është një ditë e madhe për të gjithë ne. Është, fatkeqësisht, e rëndësishme edhe për armikun tonë. Ne duhet të jemi të kujdesshëm ndaj provokimeve ruse, meqë sulmet brutale janë të mundshme”, ka thënë Zelensky në orët e vona të 23 gushtit.

Në ditën e shënimit të përvjetorit të 31-të të pavarësisë, Zelensky ka thënë se planifikon të ndajë çmime për ukrainasit që kanë kontribuar për forcimin e shtetit. Në vend të paradës, pajisjet ushtarake ruse të shkatërruara janë vënë në rrugën kryesore të Kievit si përkujtim për tentimet e dështuara të Moskës që ta marrë kontrollin e kryeqytetit ukrainas në ditët e para të luftës.

ShBA-ja me ndihmë të re për Ukrainën në vlerë prej afër 3 miliardë dollarësh

WASHINGTON, 24 GUSHT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka njoftuar për ndihmën e re ushtarake për Ukrainën në vlerë prej pothuajse 3 miliardë dollarësh. Ky njoftim u bë në ditën kur Ukraina po shënon përvjetorin e 31-të të pavarësisë dhe njëherësh edhe gjashtëmuajorin e pushtimit të nisur nga Rusia. “Jam krenar të njoftoj për ndihmën tonë më të madhe të sigurisë deri më tani: pothuajse 2.98 miliardë dollarë armë dhe pajisje ushtarake do të jepen përmes Nismës për Ndihmën e Sigurisë për Ukrainën”, tha Bideni. “Kjo paketë e ndihmës do t'i mundësojë Ukrainës të blejë sisteme të mbrojtjes ajrore, sisteme artilerish dhe municionesh, dronë dhe radarë për t'u siguruar se mund të vazhdojë ta mbrojë veten në terma afatgjatë”, shtoi Bideni. Fondet mund të përdoren për kostot e menjëhershme të luftës, përfshirë edhe blerjen e furnizimeve dhe armëve. Kjo

paketë e ndihmës është e ndarë nga Autoriteti i Tërheqjes Presidenciale, mekanizëm që i ka lejuar Bidenit ta urdhërojë transferimin e armëve dhe municioneve për forcat ukrainase nga depot ushtarake amerikane.

Të premten Pentagoni njoftoi për paketën e re nga Autoriteti i Tërheqjes Presidenciale në vlerë prej 775 milionë dollarësh. Në këtë pako të ndihmës u përfshin disa lloje të raketave, artilerisë dhe armëve të tjera dhe municioneve. Bideni lavdëroi rezistencën e Ukrainës ndaj pushtimit rus, që nisi më 24 shkurt. “Gjashtë muaj të sulmeve të vazhdueshme vetëm kanë forcuar krenarinë e ukrainasve për veten e tyre, për shtetin e tyre dhe për 31 vjetët e pavarësisë”, tha ai. “Sot dhe çdo ditë ne qëndrojmë me popullin ukrainas”, shtoi presidenti amerikan.

Në 31-vjetorin e pavarësisë së Ukrainës, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u zotua se shteti i tij do ta luftojë Rusinë “deri në fund”.



KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, MORI PJESË NË "EUROPEAN FORUM ALPBACH" NË AUSTRI

Rama në Austri: Qytetarët e Kosovës nën regjimin barbar jugosllav kanë lëvizur lirshëm nëpër Evropë. Në këtë kontekst, Rama ka thënë se qëndrimi i BE-së karshi Kosovës është i pakuptimtë. "Gjyshërit e fëmijëve që kanë lindur në Kosovën e lirë dhe që tashmë janë në moshë madhore mund të shkonin në Gjermani, të vinin në Austri dhe të punonin. Fëmijët nuk mund të lëvizin sepse nuk ka liberalizim të vizave për Kosovën", ka thënë Rama

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i ka bërë thirrje BE-së që t'i liberalizojë vizat për qytetarët e Kosovës. Rama në "European Forum Alpbach" në Austri ka thënë se qytetarët e Kosovës gjatë regjimit barbar jugosllav kanë lëvizur lirshëm nëpër Evropë. Në këtë kontekst, Rama ka thënë se qëndrimi i BE-së karshi Kosovës është i pakuptimtë. "Gjyshërit e fëmijëve që kanë lindur në Kosovën e lirë dhe që tashmë janë në moshë madhore mund të shkonin në Gjermani, të vinin në Austri dhe të punonin. Fëmijët nuk mund të lëvizin sepse nuk ka liberalizim të vizave për Kosovën", ka thënë Rama

EPOKA
ERE

Lirim GEÇI

ALPBACH, 24 GUSHT - Në Austri, ku mori pjesë në "European Forum Alpbach", kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, nuk i ka kursyer kritikën ndaj Bashkimit Evropian (BE) në lidhje me mosliberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, Rama ka thënë se qëndrimi i BE-së karshi Kosovës është i pakuptimtë. "Nuk është pozicioni interesant, pasi ne duam të jemi edhe në BE. Po punojmë për këtë. Por, sigurisht është një mënyrë për ta parë si interesante. Mënyra se si i kupton gjërat, është se kjo luftë po sfidon vetë themelet e shoqërive tona në anën perëndimore. Çështja e vërtetë nuk ka të bëjë me sa të zgjon lufta, se bombat të zgjojnë, por se sa rezistent mund të jetë Perëndimi. T'ia heqësh nga tryeza shampanjën dikujt që është mësuar ta pijë atë, duket më e dhimbshme sesa t'i marrësh nga tryeza dikujt që nuk është mësuar ta hajë atë. Çështja është rezistenca. Ju cekët pak në hyrjen tuaj, se si emocionet dhe solidariteti i muajve të parë duket se është më pak entuziast. Pasi jeta e përditshme nuk është e lehtë. Kjo do të sfidojë jo vetëm BE-në, por themelet. Nuk e shoh

Evropën të ndryshojë në asnjë lloj mënyre. Në rregull, më shumë solidaritet, më shumë takime, por Evropa është e mirë për të bërë takime. Por çështja është se si vetë Evropa po ndryshon. Nuk duket se po ndryshon. Është inerci me një luftë ku nga një anë janë rusët e nga një anë Ukraina dhe amerikanët që po japin mbështetje dhe Evropa po bashkohet me këtë mbështetje. Nuk është diçka e tillë si Evropa", ka thënë Rama.

Më tutje, kryeministri Rama ka thënë se gjatë regjimit barbar jugosllav qytetarët e Kosovës kanë lëvizur lirshëm nëpër Evropë, ndërsa sot është duke ndodhur e kundërta.

Rama ka theksuar se realiteti i Kosovës nuk është duke u trajtuar politikisht si duhet nga ana e BE-së. "Më lini t'ju jap një shembull për Kosovën. Kosova u çlirua nga fuqitë e mëdha demokratike nga një regjim barbar. Nën regjimin barbar ata mund të lëviznin lirshëm nëpër Evropë. Me çlirimtarët ata janë pengë, nuk mund të lëvizin lirshëm. Kështu që, gjyshërit e fëmijëve që kanë lindur në Kosovën e lirë dhe që tashmë janë në moshë madhore mund të shkonin në Gjermani, të vinin në Austri, edhe të punonin. Fëmijët nuk mund të lëvizin sepse nuk ka liberalizim të vizave për Kosovën. Pra, ç'është ky zgjim gjeopolitik

kur ke Ballkanin Perëndimor aty në zemër të Evropës dhe ke Bashkimin Evropian, me aq sa di unë, realitetin e vetëm gjeografik në historinë e hartave me një kufi të jashtëm dhe me një kufi të brendshëm sepse për të hyrë në Ballkanin Perëndimor duhet të hysh së pari, në Bashkimin Evropian nuk mund të hysh në asnjë prej vendeve të Ballkanit pa kaluar së pari në Bashkimin Evropian. Ky realitet gjeografik nuk trajtohet në mënyrën e duhur politikisht. Ndërkohë që ka pasur liberalizim të vizave për dhjetëra e miliona njerëz - për shembull, Ukrainën, Gjeorgjinë, më pak se 2 milionë njerëz mbahen peng aty në zemër të Evropës, pse?", ka thënë Rama, duke e përmendur edhe situatën në Mitrovicë. "Nga ana tjetër, ka tensione Mitrovica e jo Mitrovica. Kur vjen fjala për ta mbështetur suksesin e dialogut,

askush nuk mendon, 'Jepuani këtyre njerëzve lirinë të lëvizin' dhe thojuni, 'Jeni të lirë tashmë të lëvizni', në të njëjtën kohë le të ketë më shumë dialog konstruktiv. "Së dyti, shihni çfarë ndodh me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Nuk doja t'i kthehesha kësaj gjëje sepse mendova që ka përfunduar, por le t'i kthehem për hir të diskutimit. Një vend i NATO-s, Bullgaria, në mes të një lufte, që merr peng dy vende të tjera të NATO-s. Për çfarë? Për disa çështje historike dhe Bashkimi Evropian shndërrohet në një katedër të pafuqishme shtetesh përballë një shteti që ka disa pretendime historike. Nuk kam kurrfarë gjëje ndaj pretendimeve historike, por kur këto çështje historike pretendohen nga politikanët, nuk ka shanse për ta zgjidhur të vjetrën, por ka shanse për të krijuar probleme të reja historike", ka thënë Rama.

Më tutje, Rama ka pyetur se si mund të jetë Bashkimi Evropian një vend ku t'i sjellë çështjet historike në mes të njëra-tjetrës. "Imagjinoni nëse Sllovakia, Republika Çeke apo Austria apo Gjermania apo anëtarët këtu, të fillonin të mendonin në këto terma? Së treti, mendoj se nëse përpara luftës kjo ide franceze e një komuniteti të ri politik evropian ishte më tepër si një shmangie nga çështja e vërtetë, anëtarësimi sot ka një potencial të madh për t'u trajtuar, shtjelluar e për t'u përdorur si një element suksesi për të krijuar diçka tjetër të re dhe për të sjellë gjithkënd rreth tryezës sepse ne nuk jemi BE-ja por ne jemi E, Evropa, nuk kemi B-në dhe nuk e dimë se kur do ta kemi, por E-në e kemi. Kjo B që na mungon është njësoj si të jesh evropian i kategorisë së dytë", ka thënë Rama.

Osmani pas takimit me Escobarin dhe Lajçakun: Integriteti territorial i Kosovës është i paprekshëm

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se Kosova është palë konstruktive, e përgatitur dhe e angazhuar në procesin e dialogut të përqendruar në njohjen e ndërsjellë. Këtë qëndrim ajo e ka publikuar në "Facebook" pas takimit me të dërguarin e ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar dhe emisarin e BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. "Në takimin me të dërguarin e posaçëm Lajçak dhe Escobar shpreha përkushtimin e Kosovës për ta vazhduar bashkëpunimin dhe koordinimin me partnerët tanë, duke potencuar se angazhimi i vendit tonë në dialog është i bazuar në mbrojtjen e sovranitetit, rendit kushtetues dhe integritetit territorial të Kosovës, të cilat janë të paprekshme", ka shkruar Osmani. Osmani ka potencuar se Kosova

asnjëherë nuk ka kontribuar në tensione dhe se është angazhuar vazhdimisht për paqe dhe stabilitet si dhe për zgjidhje evropiane.

"Vendi ynë është i ndërtuar mbi parimin e një shoqërie multi-etnike ku të gjithë kanë të drejta të barabarta, pa dallim etnie", përfundoi e para e vendit.

Ndërsa i dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se kërçet institucionale të Kosovës e kanë siguruar që nuk duan përshkallëzim të situatës më 1 shtator, ditën nuk nis zbatimi i masës së reciprocitetit.

"Ata na siguruan se nuk duan asnjë përshkallëzim, nuk duan dhunë më 1 shtator. Pra, tani jemi këtu sot për t'u siguruar që të gjitha ato dëshira të mira dhe gjithë ai optimizëm të përketen në të mirë të vendit", ka thënë Escobari.





KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA FOLUR TË MËRKURËN PËR TAKIMIN E FUNDIT QË KA PASUR NË BRUKSEL ME PRESIDENTIN SERB ALEKSANDËR VUÇIQ

Kurti: Serbia nuk është e interesuar për normalizim të plotë

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se në takimin e fundit në Bruksel në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi pala tjetër ka nxjerrë vetëm konstatimin se nuk është e interesuar për normalizim të plotë, por për hapa të vegjël e gradualë. “Ne ishim të hapur për diskutime në këtë drejtim, mirëpo nga ndërtesa ka dalë pala tjetër”, ka thënë Kurti, duke përsëritur se autoritetet e Kosovës nuk do ta pranojnë rikthimin në qarkullim të targave KS për veturat brenda territorit të Kosovës si dhe do të zbatojnë masa reciproke për qytetarët e Serbisë sa i përket dokumentit për hyrje-dalje

kapitujve”, ka theksuar Kurti gjatë mbledhjes së qeverisë. Kryeministri Kurti ka treguar për gjashtë kapitujt e propozuar në këtë takim. “Kapitulli i parë do të duhej ta definonte qartë statusin e marrëdhënieve bilaterale mes dy vendeve dhe kontekstin ndërkombëtar, që nënkupton në njërin anë njohjen reciproke, në anën tjetër rrugën tonë drejt anëtarësimit të plotë në organizatat ndërkombëtare. Në kapitullin e dytë duhet ta trajtojmë ballafaqimin me të kaluarën, ta adresojmë të kaluarën, ku hyjnë personat e zhdukur me dhunë, viktimat e dhunës seksuale, personat e zhvendosur, drejtësia tranzicionale, dëmet materiale dhe jomateriale të luftës, kthimi i dokumentacioneve publike, por edhe i artefakteve arkeologjike dhe etnologjike”, ka thënë ai, duke shtuar se, pas trajtimit të plotë të së kaluarës, mund të diskutohet për hapat që do të ndërmerren në të

ardhmen, të cilët kanë të bëjnë me vendosjen e bashkëpunimit. “Për ne e ardhmja është bashkëpunimi që, sipas bindjes sonë, si pikënisje duhet të ketë katër liritë e dala nga procesi i Berlinit. Pra, liria e kapitalit, njerëzve, mallrave dhe shërbimeve. Në kapitullin e katërt ne ofrojmë trajtimin e të drejtave të pakicave respektive, përfshirë edhe garancitë përkatëse si për serbët në Kosovë, ashtu edhe për shqiptarët në Serbi. Në kapitullin e pestë duhet t’i rikonsiderojmë marrëveshjet e deritanishme, por jo me idenë e rinegociimit të tyre, siç është plasuar dezinformata nga pala tjetër, por të shqyrtimit të asaj se cilat prej këtyre marrëveshjeve veç janë tejkaluar nga pranimit dhe nënshkrimi i marrëveshjes ligjërish të obligueshme e finale, e cilat prej tyre duhet të vazhdojnë të implementohen.

Dhe kapitulli i fundit duhet të vendosë qartë mekanizmat për zbatimin e marrëveshjes dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve eventuale gjatë zbatimit”, ka deklaruar Kurti. Ai ka theksuar se fatkeqësisht ky elaborim i tij nuk është shoqëruar me kontribut pozitiv nga pala tjetër, e cila në vend të ideve ka nxjerrë vetëm konstatimin se nuk është e interesuar për normalizim të plotë, por për hapa të vegjël e gradualë. “Ka qenë pritja jonë, që kjo pikë e agjendës do ta konsumojë pjesën më të madhe të kohës, për çka edhe jemi treguar të gatshëm të qëndrojmë në Bruksel edhe përtej ditës së enjte, për arsye se edhe problemet e vazhdueshme në raportet mes dy vendeve tona i shohim, mes të tjerash, si simptoma të mosfillimit të bisedimeve për normalizim të plotë”, është shprehur Kurti. Kurti ka thënë se autoritetet e Kosovës nuk do ta pranojnë

**EPOKA
ERE** Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 GUSHT - Kryeministri Albin Kurti ka folur të mërkurën për takimin e fundit që ka pasur në Bruksel me presidentin serb Aleksandër Vuçiq. Ai ka thënë se ky takim ishte planifikuar për datën 19 korrik, por është shtyrë si rezultat i mosgatishmërisë për pjesëmarrje nga pala tjetër.

“Sipas agjendës së komunikuar paraprakisht, takimi trilateral i mbajtur në formatin 1+0 do të trajtonte vetëm dy tema: elementët e marrëveshjes finale dhe çështjet aktuale. Te tema e parë unë kam elaboruar në detaje këndvështrimin e palës sonë për kornizën e përgjithshme dhe elementët e saj, që do të duhej të përfshinte marrëveshja finale, në formë të gjashtë

rikthimin në qarkullim të targave KS për veturat brenda territorit të Kosovës si dhe do të zbatojnë masa reciproke për qytetarët e Serbisë sa i përket dokumentit për hyrje/dalje. “Targat KS nuk ka nevojë dhe nuk mund të rikthehen më në qarkullim. Qeveria e Republikës së Kosovës e konsideron Kosovën shtet sovran dhe buron prej kësaj shtetësie e prej këtij sovraniteti dhe nuk mund të legjitimojë neutralitet vetjak ndaj vetë statusit të saj. Një prej opsioneve ka qenë që ne të prodhojmë targa neutrale”, është shprehur Kurti. Kryeministri Kurti i quajti gënjeshtër deklaratat se pala serbe është treguar konstruktive në takimin që e patën liderët e dy vendeve më 18 gusht në Bruksel. Ambasadori amerikan në Beograd, Christopher Hill, më 23 gusht e quajti të përgatitur palën serbe për paraqitjen e saj në raundin e fundit të dialogut Kosovë - Serbi. Ndërkaq, palët e tjera, siç tha ai, nuk ishin të përgatitura “që të flisnin për specifika”. “Ne ishim të hapur për diskutime në këtë drejtim, mirëpo nga ndërtesa ka dalë pala tjetër”, ka thënë Kurti. Ndërkaq në konferencën për medie pas mbledhjes së qeverisë, Kurti ka thënë se “dialogu asimetrik ku Kosova është më shumë temë sesa palë nuk ngjan

më në Bruksel”. “Opsionet ku Kosova duhet të prodhojë targa neutrale për veten nuk vijnë në konsiderim, me mua si kryeministër, me këtë udhëheqje demokratike”, ka thënë Kurti. I pyetur se çfarë pritet të ndodhë më 1 shtator, Kurti u shpreh i vendosur se do të fillojë zbatimin e vendimit për dokumentet për hyrje-dalje sipas parimit të reciprocitetit. “Ose nuk do të ketë fare dokument të tillë në asnjërën anë, ose do të ketë në të dyja”, është shprehur ai. Kurti insistoi se 1 shtatori do të jetë ditë normale. I pyetur lidhur me barrikadat e mundshme që mund të ngrihen atje, ai tha se kjo është çështje e organeve të rendit. “Ne do të bëjmë çmos me partnerët ndërkombëtarë, me KFOR-in e organet e sigurisë, që të mos vijnë në shprehje barrikadat. Unë s’e bëj dot policin, as prokurorin. Kur bën shkelje ligji, ka organe shtetërore për këtë gjë”, ka theksuar Kurti. Kurti u shpreh i bindur që pala serbe “panevojshëm dhe krejt artificialisht” është duke eskaluar retorikën dhe veprimet në fushën e sigurisë. Ai ka thënë se qytetarët, të cilët i mbështetin “vendimet legjitime të Republikës së Kosovës, po kërcënohen vazhdimisht”. “Si e tillë, kjo përbën cenim të drejtpërdrejtë, si të sigurisë

Gjashtë kapitujt për marrëveshjen e përgjithshme me Serbinë sipas Kosovës

Kapitulli i parë: Definimi i qartë i statusit të marrëdhënieve bilaterale ndërmjet dy vendeve dhe kontekstin ndërkombëtar. Kjo nënkupton, në një anë, njohjen reciproke dhe, në anën tjetër, rrugën e Kosovës drejt anëtarësimit të plotë në organizata ndërkombëtare.

Kapitulli i dytë: Trajtimi i ballafaqimit me të kaluarën. Ta adresojmë të kaluarën ku hyjnë personat e zhdukur me dhunë, viktimat e dhunës seksuale (gjatë luftës), personat e zhvendosur, drejtësia tranzicionale, dëmet materi-

ale dhe jomateriale të luftës, kthimi i dokumentacioneve publike, por edhe i artefakteve arkeologjike dhe etnologjike.

Kapitulli i tretë: Vendosija e bashkëpunimit që si pikënisje duhet të ketë katër liritë e dala nga Procesi i Berlinit, përkatësisht liria e kapitalit, njerëzve, mallrave dhe shërbimeve.

Kapitulli i katërt: Trajtimi i të drejtave të pakicave respektive, përfshirë edhe garancitë përkatëse, si për serbët në Kosovë, ashtu edhe për shqiptarët në

Serbi.

Kapitulli i pestë: Rikonsiderimi i marrëveshjeve të deritashme, por jo me idenë e rinegociimit të tyre. Të bëhet shqyrtimi i asaj se cilat prej këtyre marrëveshjeve janë tejkaluar nga pranimi e nënshkrimi i marrëveshjes ligjrisht të obligueshme dhe finale dhe cilat marrëveshje duhet të vazhdojnë të zbatohen.

Kapitulli i gjashtë: Vendosija e mekanizmave të qartë për zbatimin e marrëveshjes dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve eventuale gjatë zbatimit.

nacionale, po ashtu edhe të rajonit në tërësi. Mendoj se këto kërcënime synojnë që padrejtësisht të krijojnë epërsinë në negociata, duke kërcënuar Bashkimin Evropian, por edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo Mbretërinë e Bashkuar, me tensione në të ardhmen”, ka

deklaruar Kurti.

Kurse kërcënimet me largimin eventual të qytetarëve të minoritetit serb nga institucionet e Kosovës, sipas Kurtit, përbëjnë “dominim të narrativës së kriminelëve si Milan Radoičiqi, e jo të atyre që integrimin e shohin si opsionin primar”. “Unë besoj

fuqishëm që përfaqësuesit e qytetarëve serbë më së paku do të duhej të përfaqësojnë dhe të shtyjnë përpara narrativa të individëve që kanë promovuar dhe vazhdojnë ta promovojnë krimin e organizuar dhe që kanë arritur deri në listën e zezë të ShBA-së”, ka thënë Kurti.



Petkoviqi reagon ndaj deklaratave të Kurtit

Drejtori i ashtuquajtur i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, ka reaguar ndaj deklaratave të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe e ka akuzuar për “një sërë të pavërtetash dhe gënjeshtërash, aq të dukshme

saqë edhe përfaqësues të respektuar ndërkombëtarë i mohojnë ato”. “E vërteta e vetme është se delegacioni i Beogradit i kryesuar nga presidenti Aleksandër Vuçiq, erdhi në Bruksel i përgatitur mirë, me zgjidhje konkrete,

konstruktive dhe të qëndrueshme për zgjidhjen e krizës me të cilën po përballemi në Kosovë dhe Metohi, e cila u konfirmua edhe nga ambasadori amerikan mbremë në Beograd, z. Christopher Hill”, ka thënë

Petkoviqi në një njoftim për media më 24 gusht. Petković, po ashtu, ka deklaruar se “pala serbe është munduar të jetë fleksibile, të gjejë zgjidhje”, porse “pala tjetër nuk ka qenë e gatshme për bisedë konkrete”. Sipas Petkoviqit, Kurti është i

gatshëm për gjithçka, përveç dialogut dhe kompromisit. Ai ka përsëritur se politika e Kurtit bazohet në refuzimin e formimit të Asociacionit së Komunave me Shumicë Serbe, për ç’gjë është rënë dakord edhe në dialogun e Brukselit.

Miratohet rregullorja për financimin e dërgimit të FSK-së jashtë vendit

PRISHTINË, 24 GUSHT - Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës të mërkurën është miratuar rregullorja për financimin e dërgimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) jashtë vendit. "Pika e shtatë është shqyrtimi i projekt-rregullore për financimin e dërgimit të FSK-së jashtë vendit. Kjo rregullore përcakton

procedurat dhe mënyrën e financimit për dërgimin e FSK-së jashtë vendit", ka thënë kryeministri Albin Kurti. Ndërsa ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se kjo rregullore është hartuar në përputhje me procedurat e parapara në rregulloren e punës së Qeverisë së Kosovës. "Ministria e Mbrojtjes ka

hartuar këtë rregullore në përputhje me procedurat e parapara në rregulloren e punës së Qeverisë së Kosovës. Aprovimi i kësaj rregulloreje përcakton mënyrën e financimit për dërgimin e FSK-së jashtë vendit, prandaj kërkon aprovimin tuaj për këtë rregullore", ka thënë ministri Mehaj.



Marrëveshja në mes të Kosovës dhe Danimarkës për 300 qeli burgu, në proces të finalizimit

PRISHTINË, 24 GUSHT - Kosova dhe Danimarka më 20 dhjetor 2021 nënshkruan një letër pëlqim, sipas së cilës, 300 qeli burgu të Kosovës do t'i jepen në shfrytëzim shtetit të Danimarkës. Por, në prill të këtij viti, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu dhe homologu i saj nga Danimarka, Nick Haekkerup, nënshkruan traktatin i cili i hap rrugë bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve në avancimin e shërbimeve korrektuese, përkrahjen e projekteve për energji të gjelbër dhe promovimin e sundimit të ligjit. Për këtë huazim, Kosova pritet të përfitojë 210 milionë euro gjatë dekadës së ardhshme.

Lidhur me këtë marrëveshje, nga Ministria e Drejtësisë kanë bërë me dije për "Telegrafin" se ekipet e të dy vendeve janë në përfundim të negociimit të aspekteve të marrëveshjes. "Aktualisht ekipet e dy vendeve janë në përfundim të negociimit të aspekteve të marrëveshjes

për financimin e projekteve për investimet në energjinë e ripërtitshme si dhe projekteve në fushën e sundimit të ligjit në Kosovë", ka deklaruar Flamur Pireva, këshilltari i ministres Haxhiu.

Pireva ka theksuar se kjo marrëveshje pritet të procedohet për ratifikim në Kuvendin e Kosovës gjatë muajve të ardhshëm.

Për ratifikim e kësaj marrëveshjeje në Kuvendin e Kosovës nevojiten dy të tretat e votave. "Kjo marrëveshje do të jetë pjesë e Traktatit gjithëpërfshirës i cili pritet që të procedohet për ratifikim në Kuvendin e Kosovës gjatë muajve të ardhshëm, ndërsa zbatimi i tij parashikohet të fillojë në muajt e parë të vitit 2023", u shpreh ai.

Më tutje, këshilltari i ministres Haxhiu ka bërë me dije se përmbajtja e Traktatit që është nënshkruar më 26 prill 2022 nuk ka ndryshuar dhe ka mbetur e njëjtë si në ditën kur është nënshkruar.



Në marrëveshjen e nënshkruar në mes të Kosovës dhe Danimarkës thuhet se Qeveria e Kosovës do t'i ofrojë Mbretërisë së Danimarkës kapacitetet e burgut, gjegjësisht institucionit korrektues që gjendet në Gjilan për 300 të burgosur, për qëllimin e ekzekutimit të dënimeve daneze dhe do t'i bëjë rregullimet e nevojshme për çdo lehtësi për të siguruar që

ai është në përputhje me ligjet dhe standardet daneze. "Qeveria e Danimarkës synon të paguajë një tarifë vjetore për përdorimin e një burgu prej 15 000 000 eurosh në varësi të numrit të të burgosurve për të cilin objekti është bërë i përshtatshëm në përputhje me rregullat dhe rregulloret daneze, me një tarifë të reduktuar për 12 muajt e parë të vitit përdorimi i

burgut si periudhë tranzicioni. Qeveria e Danimarkës synon, gjithashtu, të paguajë një tarifë fillestare prej 5 000 000sh euro për ta mbuluar periudhën e tranzicionit derisa burgu të jetë përfunduar dhe plotësuar me personel. Këto tarifa do t'i mbulojnë të gjitha kostot që lidhen me një marrëveshje të tillë", thuhet në marrëveshjen mes dy shteteve.

Kryetari i Hanit të Elezit viziton Thaçin në Hagë: I fortë e i palëkundur ashtu si në kohën e luftës



HAGË, 24 GUSHT - Kryetari i komunës së Hanit të Elezit, Mehmet Ballazhi, ka qëndruar në Hagë. Ai atje është takuar me ish-presidentin Hashim Thaçi. Ai ka theksuar se Thaçi ishte i fortë e i palëkundur ashtu si në kohën e luftës. "Kohët e vështira krijojnë njerëz të fortë sepse këta njerëz marrin vendime të guximshme në kohë të vështira. I tillë është edhe

presidenti Hashim Thaçi, i cili, edhe pse aq i ri në moshë, vetëm në vitet '20 të jetës së tij bëhet figurë kyçe si në organizime të lëvizjeve studentore e gjithëpopullore, edhe në themelimin e UÇK-së dhe çlirimit, e më pas deri në shpalljen e pavarësisë dhe në krijimin e standardeve jetësore në Kosovë. Të fortë e të palëkundur, ashtu si në kohën e luftës, e gjeta sot në

vendin ku po mbahet padrejtësisht. Dhe ashtu siç ishte plot shpresë e i bindur në fitoren e Kosovës gjatë luftës, të tillë e gjeta sot gjatë vizitës sime në Hagë, i cili ishte plot shpresë e i bindur në fitoren e tij ndaj gjykimit të padrejtë të Hagës, fitore kjo që do të jetë e gjithë Kosovës dhe shqiptarëve. Krenar me ty, President!", ka shkruar Ballazhi në "Facebook".

BSPK-ja kërkon nga çerdhet të përfshihen në grevën e përgjithshme

Prishtinë, 24 gusht - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) u ka bërë thirrje edhe kujdestareve të kopshteve që të përfshihen në grevën e

përgjithshme e cila pritet të mbahet të enjten. BSPK-ja më 17 gusht ka vendosur për grevën e përgjithshme, teksa ka thënë se do të vazhdojë deri në

plotësimin e kërkesave të saj nga ana e qeverisë Kurti. Grevës i janë bashkuar të gjitha sindikatat, përfshirë edhe SBASHK-u.

Madje më herët kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, kishte thënë se fajtor kryesor i mbylljes së kopshteve e shkollave është qeveria Kurti.



Gjashtë muaj të rezistencës, qëndrueshmërisë dhe vendosmërisë së Ukrainës



Nga ambasadori i SHBA-së në Kosovë,
Jeffrey M. HOVENIER

Data 24 gusht shënon 31-vjetorin e pavarësisë së Ukrainës. Për keqardhje, në këtë ditë gjithashtu bëhen gjashtë muaj prej kur qeveria ruse filloi pushtimin e paprovokuar dhe në shkallë të gjerë të Ukrainës, sulm ky kaq tronditës për bashkësinë ndërkombëtare sa u dënua plotësisht nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dhe nxitu dy vende të reja të kërkojnë anëtarësim në aleancën e NATO-s.

Ukraina, e sulmuar nga Rusia që nga viti 2014, ka gjysmë viti që po iu reziston bombardimeve masive, rrethimeve të qyteteve dhe mizorive kundër popullit të saj. Ukraina po lufton për të mbrojtur jo vetëm demokracinë e saj, por edhe mbijetesën si shtet i pavarur. Kosova ka reaguar shpejt duke dënuar pushtimin e paprovokuar dhe të pajustificuar nga ana e Rusisë dhe duke shprehur solidaritet të plotë me popullin e Ukrainës. Kosova u rreshtua menjëherë me sanksionet e SHBA-ve dhe BE-së në mbështetje të Ukrainës. Kosova tregoi zemërgjerësinë dhe përkushtimin e saj ndaj demokracisë duke ua hapur dyert ukrainasve që kishin nevojë për strehim, përfshirë edhe gazetarëve, që ata të mund të vazhdonin të përmbushnin rolin e tyre jetik për të mbajtur shtypin e Ukrainës të lirë dhe të pavarur. Duhet të qëndrojmë të bashkuar në mbështetjen për sovranitetin, demokracinë dhe aspiratat evropiane të Ukrainës. Agresioni i Rusisë kundër Ukrainës është ndër ngjarjet më të rëndësishme për Evropën që nga Lufta e Dytë Botërore. Forcat ruse kanë kryer krime lufte dhe mizori dhe lufta e tyre në

Ukrainë do të ketë pasojë negative në pasigurinë ushqimore në nivel botëror dhe ekonominë botërore për vite me radhë.

Reagimi mbarë-botëror ndaj luftës kundër Ukrainës ka qenë aq i thellë dhe i ka prekur aq shumë njerëz sepse në vazhden e kësaj lufte, pothuajse çdo ditë kemi parë dëshmi të dhunës, shkatërrimit, rrënimit dhe vdekjes.

Njerëzit me të drejtë i kanë pritur me zemërim raportet që zyrtarët rusë po i mbikëqyrin të ashtuquajturat operacione të „filtrimit”, së bashku me provat se këto forca kanë marrë në pyetje, ndaluar, zhvendosur ose dëbuar me forcë miliona qytetarë ukrainas, përfshirë fëmijë.

Të gjithë i kemi parë pamjet e pasojave të bombave ruse duke i goditur civilët e strehuar në shkolla, teatro dhe spitale. Në qytetet si Bucha dhe Irpin, mediat ndërkombëtare dhe organizatat humanitare kanë dokumentuar ekzekutime, torturimin e personelit në uniformë dhe civilëve, kurse në qytete të tëra si Mariupoli kanë parë shkëputjen e shërbimeve elementare përderisa po përballëshin me pushtim shkatërrues dhe brutal. Gjithashtu, ka prova se Rusia synon të përpiqet të aneksojë me forcë territor shtesë të Ukrainës, duke shpalosur një variant të „doracakut të aneksimit” që e kemi parë në vitin 2014, duke vendosur përfaqësues të paligjshëm për të aranzhuar referendum të kurditur për t’ju bashkuar Rusisë. Aneksimi me forcë do të përbente shkelje të rëndë të Kartës së OKB-së dhe ne nuk do të lejojmë që kjo të kalojë pa u sfiduar apo pa kosto.

Në mes të gjithë kësaj vdekjeje dhe shkatërrimi, ukrainasit kanë

gjetur strehim në bunkerët nëntokësorë, duke rrezikuar jetën për të mbledhur prova të mizorive dhe kanë luftuar, nganjëherë nga një rrugë në tjetrën, për të mbajtur gjallë popullin, gjuhën, lirinë dhe identitetin e tyre. Qëndrueshmëria dhe vendosmëria e popullit të Ukrainës e kanë frymëzuar botën për të mbështetur luftën e tij për liri. Forcat e armatosura të Ukrainës kanë luftuar trimërisht për të mbrojtur vlerat që të gjithë i kemi për zemër.

Shtetet e Bashkuara po mbështesin një varg hetimesh ndërkombëtare për mizoritë e kryera në Ukrainë. Kjo përfshin hetimet nga Gjykata Ndërkombëtare Penale, Kombet e Bashkuara dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Shtetet e Bashkuara janë të gatshme për të mbështetur gjykatat vendore nëpër tërë botën që kanë juridiksion mbi individët e akuzuar për kryerjen e krimeve ndërkombëtare. Gjithashtu, do të vazhdojmë të punojmë me bashkësinë ndërkombëtare për të ndihmuar rindërtimin e Ukrainës.

Pasojat e luftës së Rusisë nuk kufizohen vetëm në Ukrainë. Agresioni i Rusisë ka përmbytur tregtinë globale të grurit, duke rrezikuar sigurinë ushqimore për shumë popuj. Kriza e tanishme gjithashtu ka përsheptuar inflacionin dhe ka rritur çmimet me pakicë anëmbanë botës.

Ukraina është përballur me sulme shkatërruese në tokën bujqësore, infrastrukturën transportuese dhe depot, duke penguar aftësinë e saj për të ushqyer qytetarët e saj dhe shumë të tjerë anëmbanë botës. Në shumë raste, forcat ruse thjesht i kanë djegur arat ukrainase. Bujqit ukrainas, që dikur shpresonin të kishin rekord të korrijeve të verës, tani përpiqen të zëvendësojnë pajisjet e vjedhura dhe të dëmtuara dhe luftojnë për të mbajtur gjallë familjet dhe komunitetet e tyre. Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të mbështesin të gjitha përpjekjet për të siguruar që prodhimet ushqimore ukrainase arrijnë në tregjet botërore. Do të vazhdojmë të shfrytëzojmë forumet si G20 për të shtyrë Rusinë të respektojë ujdinë e arritur rishtazi për të lejuar kalimin e dërgesave me mallra ushqimore nga portet e Ukrainës në Detin e Zi. Me sulmin e pacipë të Rusisë në

portin e Odesës vetëm 24 orë pas arritjes së kësaj ujdie, bashkë me sulmet e vazhdueshme ndaj infrastrukturës transportuese dhe bujqësore, presioni ndërkombëtar për të zhblokuar eksportet e mallrave ushqimore ukrainase do të vazhdojë të jetë thelbësor.

Pavarësisht kostos së madhe që Vladimir Putin i ka shkaktuar Ukrainës dhe botës, sanksionet e vëna nga Shtetet e Bashkuara dhe partnerët e aleatët tanë kanë për qëllim që të detyrojnë Kremlinin të ndërpresë dhunën dhe po e dëmtojnë ekonominë e Rusisë, për çka është nevojitur ndërhyrja e paprecedentë (dhe e paqëndrueshme) e Kremlinit për të parandaluar dëme të konsiderueshme.

Ekonomistët parashikojnë se, në afat më të gjatë, përderisa sanksionet zgjerohen dhe ashpërsohen, qeverisë ruse do t’i mbarojnë taktikat e zvarritjes dhe populli rus do ta përjetojë në lëkurë të vet koston e vërtetë të veprimeve të saj.

Provat tashmë mund të shihen nga të gjithë. Për muaj me radhë, Kremlinin nuk i raportuar metrikat makroekonomike. Përkundër pretendimeve të Putinit se Rusia është në gjendje më të mirë se BE-ja, shifrat e vërteta tregojnë të kundërtën, meqenëse ekonomia e Rusisë është zvogëluar për katër për qind në tremujorin e dytë të vitit 2022, kurse ekonomia e BE-së është rritur për të njëjtën marzhë. Rusia tashmë nuk ka arritur të paguajë dy këste të borxhit dhe për herë të parë në më shumë se një shekull nuk ka arritur të paguajë borxhin në valutë të huaj.

Sanksionet e bashkërenditura kanë ngrirë më shumë se gjysmën e rezervave të Bankës Qendrore ruse, para këto që përndryshe Kremlinin do t’i përdorte për financimin e makinerisë së tij të luftës. Mungesa e qasjes në mallra të importuara dhe të gatshme, veçanërisht mallrat me teknologji të sofistikuar të integruar, ka krijuar pengesa dhe, me kalimin e kohës, do të dëmtojë më shumë prodhimin, transportin dhe tregtinë, dhe më e rëndësishmja, prodhimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve ushtarake.

Përderisa sanksionet vazhdojnë të zvogëlojnë aftësitë luftuese të Putinit, forcat ukrainase me sukses po e mbrojnë vendin e tyre dhe populli ukrainas është më i bashkuar se kurrë më parë.

Prej shkurtit, kur Rusia filloi pushtimin në shkallë të gjerë, më shumë se 50 shtete i janë bashkuar Shteteve të Bashkuara për t’i dërguar Ukrainës ndihmë në aspektin e sigurisë. Bashkërisht, po përsheptojmë dërgesën e më shumë armëve, të cilat Ukraina po i përdor me aq efikasitet për tu mbrojtur.

Shtetet e Bashkuara i kanë zotuar pothuajse 10 miliardë dollarë në ndihmë për siguri prej 24 shkurtit kur Rusia filloi luftën e paramenduar, të paprovokuar dhe brutale kundër Ukrainës. Kjo përfshin sisteme dhe municion artilerie, automjete të blinduara dhe sisteme të avancuara të mbrojtjes ajrore për Ukrainën.

Si rezultat i rezistencës së Ukrainës, më shumë se 2.6 milionë të zhvendosur janë kthyer në Ukrainë - më shumë se një e treta e atyre që ikën fillimisht.

Shoqëria civile ukrainase i ka zgjeruar përpjekjet për reagim humanitar, duke organizuar ndarjen e ndihmës dhe rindërtimin e komuniteteve. Punëtorët humanitarë, shumica e të cilëve janë ukrainas, po veprojnë në të gjitha 24 qarqet, duke i ndihmuar pothuajse 12 milionë njerëz. Shtetet e Bashkuara janë krenare për mbështetjen e këtyre përpjekjeve që vetëm gjatë këtij viti kanë arritur shumën prej pothuajse 1.2 miliardë dollarë për ndihmë humanitare.

Nga Rruga Kryesore e Majdani në Kapitol Hill e deri te Konsiliumi i BE-së, mbështetja e gjerë për Ukrainën ka treguar se sulmet e paprovokuara në shtetet sovraane e të pavarura nuk do të kalojnë pa reagim dhe do të kenë çmim tepër të lartë. Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e partnerët e saj nëpër tërë botën, përfshirë popullin e Kosovës, janë më të bashkuar se kurrë.

Do të vazhdojmë të qëndrojmë krah Ukrainës dhe të përkrhim luftën e saj për mbijetesë përderisa njëkohësisht do të punojmë në forcimin e sigurisë dhe vlerave demokratike të Evropës. Qëndrojmë krah Ukrainës sepse kufijtë dhe furnizimet me mall ushqimor nuk janë mundësi për pazar. Qëndrojmë krah Ukrainës sepse të drejtat e njeriut janë të pakundërshtueshme. Qëndrojmë krah Ukrainës sepse është gjëja e duhur për ta bërë.

Kurti: Reduktimet e rrymës janë të domosdoshme

PRISHTINË, 24 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se reduktimet e rrymës dhe remonti në termocentrale janë masa të domosdoshme për ta përballuar importin e energjisë në muajt e dimrit. Ai këto deklarata i ka bërë në një konferencë për medie me gazetarët në Prishtinë.

“Në ditën kur kanë filluar reduktimet, konsumi i energjisë ka qenë 240 megavatë në orë më shumë sesa prodhimi. Pra, konsumin e kemi pasur për

240 megavatë orë më shumë sesa gjenerimi. Çmimi në HUPX (berzën hungareze të energjisë) ka qenë rreth 430 euro për megavat orë. Importi është shumë i kushtueshëm dhe pa këto masa është i papërballueshëm në dimër”, ka thënë Kurti.

Sipas tij, bashkëpunimi i shtuar me Shqipërinë për energjinë ka ardhur për shkak të remontit në bllokun “B2” të termocentralit “Kosova B” dhe për shkak se blloku “A5” në termocentralin “Kosova A” nuk ka punuar.



Fillon instalimi i njehsorëve të “Termokos”-it



PRISHTINË, 24 GUSHT - Ngrohtorja më e madhe në Kosovë, “Termokos”, e cila furnizon një numër gjithnjë në rritje të konsumatorëve, tashmë ka filluar projektin madhor të instalimit të sistemit të ri të matjes së ngrohjes dhe faturimit, të quajtur “Prishtina HeatSave”. Me ndihmën e Fondacionit të Mileniumit të Kosovës dhe agjencisë federale amerikane MCC, nga sezoni dimëror 2023, afër 17 000 banesa dhe lokale do të pajisen me njehsorë, valvula kontrolluese, alokatorë të ngrohjes si dhe koka termike në çdo radiator të tyre. Me këtë investim, ku merr pjesë edhe

komuna e Prishtinës, priten përfitime të mëdha: Konsumatorët do të fillojnë të paguajnë sipas shpenzimit e jo me metra katrorë; Konsumatorët do të kenë mundësi të kontrollit total të ngrohjes me pajisje moderne; Nëpërmjet projektit ‘Prishtina HeatSave’ konsumatorët do të përfitojnë falas të gjitha pajisjet dhe instalimin; Duke ndryshuar shprehitë dhe duke kursyer, ky projekt parashihet të krijojë kursime prej 15 deri në 30 % të energjisë totale termike që e shpenzon ‘Termokos’-i, duke liruar kështu kapacitetet për zgjerim të mëtutjeshëm të rrjetit.

Qeveria ndan 41 milionë euro mbështetje për qytetarët për tejkalimin e krizës energjetike



PRISHTINË, 24 GUSHT - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për ndarjen e 41 milionë eurove për Ministrinë e Ekonomisë si mbështetje për qytetarët për tejkalimin e krizës energjetike. Sipas kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë, ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se mjetet do të merren nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike dhe do të transferohen në Ministrinë e Ekonomisë. “Propozim-vendimi tjetër ka të bëjë me kërkesën e Ministrisë së

Ekonomisë që ishte për ndarjen e 41 milionë eurove për zbatimin e vendimit 13/19 të datës të datës 14 korrik i plotësuar dhe ndryshuar lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike për zbatimin e masës 3.17. Pra mbështetje për tejkalimin e krizës energjetike, pra kjo ka të bëjë edhe me zotimin që kemi si qeveri, për t’i mbështetur qytetarët për tejkalimin e krizës energjetike dhe përballimin e tarifave të shtrenjta të importit”, ka thënë Murati.

GAP-i: Prodhimi i energjisë elektrike nuk po i mbulon kërkesat e konsumatorëve

PRISHTINË, 24 GUSHT - Instituti për Studime të Avancuara (GAP) ka njoftuar se prodhimi i energjisë elektrike në vend është duke i mbuluar kërkesat e konsumatorëve. Për këtë shkak, GAP-i ka theksuar se janë duke u aplikuar reduktimet. Sipas GAP-it, edhe Shqipëria nuk është duke arritur ta furnizojë Kosovën nga deponimet e saj atje përgjatë tërë periudhës së nevojitur.

“Javët e fundit konsumi mesatar ditor i energjisë elektrike në Kosovë në orë është rreth 560 MWh, ndërsa prodhimi rreth 530 MWh. Kërkesa për energji elektrike në Kosovë është më e lartë nga mesdita deri në mbrëmje edhe për shkak se ‘TC Kosova B2’ është në riparim të planifikuar nga java e dytë e muajit gusht, Kosova nuk po arrin t’i përmbushë kërkesat e

brendshme të energjisë elektrike në këtë periudhë të ditës. Meqë edhe çmimet e energjisë elektrike në tregjet ndërkombëtare po shënojnë çmime rekord dhe Shqipëria (KESH) nuk po arrin ta furnizojë Kosovën nga deponimet e saj atje përgjatë tërë periudhës së nevojitur, kjo po ndikon që në Kosovë të aplikohen reduktime”, ka njoftuar GAP-i.



Çfarë do të mendojnë për ne brezat e ardhshëm?

Nga William MACASKILL

Romakët skllavëruan njerëzit, vunë në zbatim një patriarki të ngurtë, dhe kënaqeshin me spektaklin e të burgosurve që torturoheshin në Koloseum. Mendjet më të larta të botës së lashtë perëndimore – njerëz të famshëm si Aristoteli, veprat e të cilit mësohen ende sot nëpër universitete – e mbrojtën skllavërinë si një praktikë krejtësisht të natyrshme dhe të duhur.

Në fakt, që nga fillimi i epokës bujqësore dhe deri në shekullin XIX-të, skllavëria ishte e kudondodhur në mbarë botën. Është e vështirë të kuptohet se si paraardhësit tanë mund të kenë gabuar kaq shumë. Që atëherë, ne kemi arritur një përparim real. Edhe pse jemi ende shumë larg përsosmërisë, shoqëria e sotme është në shumë aspekte shumë më humane dhe më e drejtë se dikur.

Por pse dikush duhet të mendojë, se ky rrugëtim i përparimit moral është afër fundit? Duke pasur parasysh historikun e njerëzimit, edhe sot ne po bëjmë pothuajse me siguri gabime të rënda morale, ashtu si paraardhësit tanë. Kur brezat e ardhshëm të kthejnë kokën pas në epokën tonë, ata mund të na shohin me një sy kritik, siç bëjmë ne sot me romakët.

Mendimi për gabimet tona të mundshme morale, është një ushtrim sfidues: Ai kërkon që ne të perceptojmë dhe të shqyrtojmë gjithçka bën njerëzimi. Disa nga mëkatet tona janë të dukshme. Për shembull, mënyra se si i trajtojmë të burgosurit. Ndryshe nga romakët, ne nuk vëmë më në skenë si një spektakël publik vuajtjet e të burgosurve.

Prapëseprapë, ne i nënshtrijmë ata ndaj kushteve – si izolimi i zgjatur – që brezat e ardhshëm të shkolluar ka të ngjarë t'i konsiderojnë të tmerrshme. Dëmi i madh që u shkaktojmë të burgosurve (dhe familjeve të tyre të pafajshme) është shpesh më i madh se dëmi i shkakuar nga rrahja me shkopinj, një praktikë që me të drejtë e kemi braktisur.

Apo mendoni pak se si i trajtojmë kafshët. Çdo vit, njerëzimi ther 80 miliardë kafshë për të kënaqur preferencat e tij në kuzhinë. Shumica e tyre janë pula, dhe jeta e tyre është e mjerueshme. Zogjtë meshkuj theren, përfundojnë duke u bërë salçiçe. Zogjve femra u priten majat e sqepave dhe shumica mbyllen në kafaze të ngushtë për të bërë vezë.

Mesatarisht, një vakt i rregullt që përmban pulë apo vezë kushton të paktën 10 orë torturorese të jetës së një pule. Dhe më shumë pula do të vriten brenda 2 viteve



të ardhshme sesa numri i të gjithë njerëzve që kanë jetuar ndonjëherë. Ngjashëm, derrat tredhen dhe u pritet bishti. Lopëve u hiqen brirët dhe damkosen me një hekur të nxehtë pa anestezi.

Nëse kafshët kanë një lloj rëndësie, trajtimi ynë ndaj tyre është një krim me përmasa epike. Dhe këto dështime etike ndajnë një model të përbashkët. Grupime e privuara nga të drejta dhe të marginalizuara – si të varfrit, të burgosur, emigrantët, madje edhe kafshët nëpër ferma, janë jashtë vëmendjes së të tjerëve.

Brezat e ardhshëm do të analizojnë se si ne i fshehëm këto grupe nga syri i shoqërisë, duke i lejuar vetes të injorojmë interesat e tyre bazike. Sigurisht, kjo nuk është diçka e re. Por ka një dimension tjetër, për të cilin flitet shumë më pak. Kur njerëzit e ardhshëm të kthejnë kokën pas, ata do të vërejnë shpërfilljen tonë për një grup tjetër të privuar nga e drejta: vetë ata. Brezat e ardhshëm nuk mund të votojnë në lidhje me zgjedhjet tona, apo të flasin me kalimin e kohës, dhe të na nxisin të veprojme ndryshe. Ata janë pa zë. Është e lehtë të imagjinohet se në vitin 2300, pasardhësit tanë do të shohin pas, dhe do ta dënojnë dështimin tonë për të marrë parasysh interesat e tyre. Dhe reziqet e këtij dështimi të mundshëm janë shumë të mëdha. Për shkak të numrit të madh të njerëzve të ardhshëm, dhe për shkak se mirëqenia e

tyre është tërësisht e neglizhuar, unë besoj se mbrojtja e brezave të ardhshëm duhet të jetë një përparësi morale kryesore e kohës sonë.

Kur marrim parasysh se cilat grupe po neglizhojmë, është shumë e lehtë të harrojmë shumicën e njerëzve që ka të ngjarë të jetojnë ndonjëherë. Ja një shembull tipik i shpërfilljes sonë ndaj brezave të ardhshëm. Pavarësisht ziles së fortë të zgjimit që na dha Covid-19, shumica e qeverive mbeten thuajse tërësisht të papërgatitura për pandemitë e ardhshme.

Për shembull, SHBA-ja shpenzon ende vetëm 10 miliardë dollarë në vit për përgatitjen për pandemitë, krahasuar me rreth 280 miliardë dollarë për antiterrorizmin. Që nga 11 Shtatori 2001, rreth 500 njerëz kanë vdekur në SHBA si rezultat i një akti terrorist. Ndërkohë më 1 mijë herë më shumë kanë vdekur nga Covid-19.

Nëse nuk i shtojmë ndjeshëm përpjekjet tona për të parandaluar pandeminë e ardhshme, ka shumë të ngjarë që një patogjen shumë më vdekjeprurës sesa koronavirusi, të shkaktojë një shfarosje në masë. Rreziku i një aksidenti nga eksperimentet mbi pandemitë më vdekjeprurëse vetëm sa do të rritet.

Por nëse pasardhësit tanë jetojnë në një distopi post-apokaliptike, si do ta shohin ata dështimin tonë për të

parandaluar katastrofën? Dhe çfarë do të mendojnë pasardhësit tanë për zgjedhjen tonë për të lëshuar në atmosferë dioksid karboni? Dioksidi i karbonit do të ndotë ajrin që ata thithin për mijëra vjet.

Niveli i detit do të vazhdojë të rritet edhe për 10.000 vitet në vazhdim. Dhe kur bëhet fjalë për ndryshimet klimatike dhe gatishmërinë ndaj pandemive, ka hapa konkretë që mund të ndërmarim që sot. Ne mund të investojmë tek teknologjia më premtuese e energjisë së pastër, si bateritë, panelet diellore dhe fuqia e zgjeruar gjeotermale, për të zbutur ndryshimet klimatike. Për të shmangur pandeminë e ardhshme, ne mund të zhvillojmë pajisje mbrojtëse personale të gjeneratës së ardhshme, dhe sisteme të paralajmërimit të hershëm që zbulojnë patogjenë të rinj tek ujërat e zeza. Nëse nuk veprojme tani për të mbrojtur të ardhmen, pasardhësit tanë do të na gjykojnë ashpër për dritëshkurtësinë tonë.

Por ndryshimet klimatike dhe pandemitë, nuk janë të vetmet katastrofa që meritojnë shumë më tepër vëmendje. Si mund të korrigojmë një krizë të rëndë në marrëdhëniet ndërkombëtare, dhe të zbusim rrezikun e zhytjes në Luftën e Tretë Botërore?


Inteligjenca artificiale po përparon me shpejtësi. Si mund ta parandalojmë që ajo përdoret si një armë nga aktorë të këqij, dhe si mund të sigurojmë që ajo të jetë në përputhje me vlerat e njerëzimit? Dhe si mund të

parandalojmë që ideologjitë autoritare dhe jo-liberale të mos fitojnë terren, dhe të sigurojmë që përparimi moral të vazhdojë gjatë në të ardhmen?

Këto janë probleme të vështira. Por gjatë dekadës së fundit, ne kemi arritur një përparim të vërtetë. Grupime të shumta kërkimore janë duke punuar, për të siguruar që nga AI të përfitojë njerëzimi, dhe jo që ai të shkatërrohet prej saj. Ndërkohë organizata tilla si Alvea, Observatori i Acideve Nukleike dhe Projekti SecureDNA po zhvillojnë zgjidhje konkrete për të mbrojtur njerëzit, tani dhe në të ardhmen, nga katastrofat biologjike.

Por ka shumë më tepër që duhen bërë. Ne duhet të vazhdojmë të zgjerojmë rrethin e shqetësimit tonë moral, në mënyrë që të përfshijmë të varfrit, të burgosurit, emigrantët, kafshët dhe të gjithë të tjerët, që mund të lulëzojnë ose vuajnë, sot dhe në të ardhmen e largët. Çfarë do të mendojnë brezat e ardhshëm për ne? Ndoshta do të na shohin si egoistë dhe miopë. Ose ndoshta do të na shohin me mirënjohje, për hapat që kemi marrë për t'u lënë atyre një botë më të mirë. Zgjedhja është e jona.

Shënim: William MacAskill, profesor i asociuar i filozofisë në Universitetin e Oksfordit, dhe autor i librit "Çfarë i detyrohem të ardhmes"! "The Atlantic" – Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Ballkani synon kualifikimin në fazën e grupeve

Skuadra e Ballkanit është e motivuar për ta shkruar historinë e sportit të Kosovës, duke u kualifikuar në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës. Kampionët e Kosovës e kanë kryer gjysmën e punës pasi e kanë fituar ndeshjen e parë të zhvilluar me Shkupin me rezultat 1-2, ndërsa sonte i mjafton barazimi. Ndeshja Ballkani - Shkupi zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" me fillim nga ora 20:00

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 GUSHT - Skuadra e Ballkanit po synon t'i vazhdojë sukseset në arenën ndërkombëtare duke siguruar fazën e grupeve në Ligën e Konferencës që do të ishte sukses historik jo vetëm për skuadrën nga Suhareka, por edhe për mbarë futbollin e Kosovës. Klubi që shkroi historinë në futbollin vendor, duke e fituar për herë të parë titullin e kampionit, ka arritur të kualifikohet deri në fazën e "play-off"-it, madje e ka fituar edhe ndeshjen e parë kundër FC Shkupit si mysafir (1-2) dhe tash i mjafton një barazim në ndeshjen kthyesë për ta siguruar kualifikimin historik. Trajneri Ilir Daja, i cili po i prin me mjaft sukses Ballkanit, ka

thënë se klubi që ai e drejton duhet të jetë i koncentruar në ndeshjen kthyesë që zhvillohet sonte (e enjte) në stadiumin "Fadil Vokrri". "Ne kemi bërë hap të mirë në udhëtim. Shkupi është ekip i mirë, por duhet të jemi të kujdesshëm dhe të koncentruar. Por edhe ne kemi kualitetet tona. Kemi ndeshje të vështirë. E rëndësishme është që është ndeshje mes ekipeve shqiptare. Duhet t'i presim si na pritën në Shkup. Do të bëjmë maksimumin për ta siguruar kualifikimin", ka thënë Daja. Skuadra e Ballkanit nëpërmjet faqes zyrtare ka kërkuar përkrahje për përballjen historike ndaj FC Shkupit "Të enjten me fillim nga ora 20:00 zhvillohet përballja historike kundër FC Shkupit. Na duhet përkrahja e të gjithë sportdashësve kosovarë pasi që me barazim apo fitore ne




kualifikohemi tutje në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës dhe shënojmë histori në futbollin kosovar duke qenë ekipi i parë që merr pjesë në këtë kompeticion", thuhet në kërkesën e skuadrës kampione. Të mërkurën Ballkani ka njoftuar se në stadiumin "Fadil

Vokrri" kanë mbetur edhe 1 000 vende të lira dhe biletat për ato vende do të shiten të enjten në Prishtinë te "New Born". Edhe më madhështore pritet të jetë ndeshja në mes të Ballkanit dhe Shkupit, pasi pjesëmarrjen e kanë konfirmuar rreth 700 anëtarë të tifo-grupit

"Shvercerat". "Në stadiumin 'Fadil Vokrri' do të ketë më shumë se 700 shvercera. Shumë tjerë do të udhëtojnë edhe me vetura private. Jam i sigurt që do të kalojmë mirë. Ne po shkojmë në vendin tonë dhe aty jemi në shtëpi", ka thënë Jusuf Ramadani, kryetar i tifogrupit.

Superliga e basketbollit fillon me derbi



PRISHTINË, 24 GUSHT - Në zyrat e Federatës së Basketbollit të Kosovës të mërkurën është hedhur shorti për edicionin e ri të Prince Caffè Superliga, Superliga e Femrave, Liga e Parë në dy kategoritë si dhe Liga e Dytë për edicionin 2022/23. Prince Caffè Superliga qysh në xhiron e parë pritet të fillojë me superndeshje, me dy rivalët e vjetra, Sigal Prishtina dhe Peja, kurse ndeshjet e tjera të xhiros së parë do të jenë Trepça - Ponte Prizreni, Bashkimi - Vëllaznimi dhe Rahoveci - Golden Eagle Ylli.

Këto ndeshje do të zhvillohen mes datave 10 dhe 11 shtator. Tek Superliga e Femrave, Prishtina pret Vëllaznimin, Trepça-United Basketball, kurse Bashkimi-Penza pritet të jetë ndeshja më interesante e kësaj xhiroje. Ndeshjet e para në elitën e basketbollit të femrave do të zhvillohen më 15 dhe 16 tetor. Liga e Parë e Meshkujve ka sjellë këto përballje në javën e parë: Drita-Prishtina e Re, Istogu-Bora, Happy Dukagjini-Gjakova re Re, New Basket- Marigona Hill Prishtina dhe Borea-Vushtrria.

Ndeshjet zhvillohen me datat 15/16 tetor. Ndërkohë, Liga e Parë e Femrave ka sjellë këto çifte Istogu-Kastrioti, Drita WBC Bashkimi, AA Prishtina-Vushtria Basket, Gjinnazisti-Peja 03. Ndeshjet e kësaj xhiroje zhvillohen me datat 15-16 tetor. Liga e Dytë e Meshkujve zhvillon ndeshjet e para mes datave 15-16 tetor, kurse ndeshja hapëse në këtë ligë është mes Kaçaniku dhe MegaSport. Takimet e tjera janë Sfera-Llapi, Kosovari-Vitia06 dhe ndeshja e fundit Gjakova-Lipjani.

FC Prishtina 01 përforcohet me Alajn

PRISHTINË, 24 GUSHT - FC Prishtina 01 është njoftuar se ka arritur marrëveshje me legjendën e futbollit, Ramadan Alajn. Një prej lojtarëve më të mirë të trojeve shqiptare do t'i mbrojë ngjyrat bardhekaltër sezonin e ardhshëm. Alaj është shpallur pesë herë kampion i Kosovës, 1 herë me Bamboo Prishtina dhe 4 herë

me Fc Liburn. Ai ka bërë karrierë te FC Pallma Pharm & Vëllazërit Kukaj 2008/09, FC Bamboo 2009/10 dhe 2010/11, për të kaluar te FC Benago në Pragë të Çekisë. Pastaj Alaj kaloi në vitin 2011 te Liburni i Gjakovës, ku deri në vitin 2022 bëri histori me këtë klub. Alaj ka luajtur në Ligën e Kampionëve me FC

Liburnin, FC Feniksin dhe FC Tiranën. "Pjesë e Përfaqësueses së Kosovës për shumë vite, si një prej lojtarëve kryesorë. FC Prishtina 01 me 'Danin' dhe pjesën tjetër të skuadrës beson fuqishëm që do t'i ktheje trofetë në kryeqytet. Përpara, përpara 'bardhekaltër', thuhet në njoftimin e FC Prishtina 01.



Ronaldo kurrë nuk ka qenë opion për Bayernin

MUNCHEN, 24 GUSHT - Cristiano Ronaldo mbetet një temë e nxehtë e merkatos me sulmuesin që ende nuk po arrin të largohet nga Manchester Unitedi për ta shijuar edhe një sezon më shumë si protagonist në Ligën e Kampionëve. Një

nga klubet e përmendura gjatë kësaj vere si destinacioni i mundshëm për luzitanin ishte edhe Bayern Munchen. "Bavarezët" kurrë nuk e pranuan interesimin për CR7 dhe së fundmi drejtori sportiv i klubit, Hasan Salihamidziq,

theksoi se bordi vendosi kundër transferimit të 37-vjeçarit. "Sulmi i skuadrës sonë është i plotësuar, kemi tetë lojtarë për katër pozicione. Kemi në organikë lojtarë nga më të mirët në qarkullim në moshën e tyre më ideale. Kemi talente

dhe duhet t'u sigurojmë edhe atyre minuta. Kështu, sa i takon Ronaldos, bordi i klubit vendosi të vijojë me këtë projekt, ndaj firma me portugezin nuk ishte kurrë një opion. Jemi të lumtur se si është e ndërtuar skuadra", ka thënë Salihamidziq.



Mavraj konfirmon bisedimet me Partizanin: Ide e bukur ta mbyll karrierën në Shqipëri

TIRANË, 24 GUSHT - Mërgim Mavraj është emri më i madh i dalë në skenë në këtë merkato për një transferim të mundshëm te Partizani. Pas largimit të Belicës, të kuqtë janë në kërkim të një tjetër qendërmbrojtësi, që do të shtonte opsionet dhe konkurrencën në sulm. "Panorama Sport" raportoi ekskluzivisht para disa ditësh se "demat" kanë kontaktuar Mërgim Mavrajn, ish-kapitenin e Kombëtares, që ka luajtur me ekipe si Hamburg, Ingolstadt apo Gruther Furth. Vetë Mavraj është prononcuar në lidhje me këtë temë, ku duket pro një lëvizjeje të tillë. "Po, mund t'ju konfirmoj që kam lejuar të nisim bisedimet", ka thënë Mavraj. "Për momentin vetëm kaq mund të them. Nuk e di se si mund të shkojë, nëse do të ketë një bashkëpunim apo jo. Nga ana ime mund të them se fakti që një klub si Partizani është interesuar për mua që të jem pjesë e tij, është një vlerësim shumë i madh. Të rikthehem prapë në ato fusha me tifozët e mrekullueshëm



shqiptarë, në fushat ku kemi pasur shumë kujtime, do të ishte një mënyrë nostalgjike për t'i prekur edhe një herë ato stadione, ato fusha", ka shtuar mbrojtësi Mavraj. "Madje, ja tani që po i përmend për ju, sa më shumë i mendoj, aq më shumë më shtohet dëshira. Gjithsesi, nuk

e di se si do të mbyllet, janë shumë faktorë. Nga ana ime është një ide shumë e mirë, shumë e bukur, që ta mbyll karrierën në Shqipëri. Po e përfundoj duke e theksuar edhe një herë, që a do të më jepet apo jo mundësia, nuk e di", ka deklaruar ndër të tjera për "OverSport", ish-kapiteni kuqezi.

Verstappeni shënjestron rekordin e Schumacherit dhe Vettelit: Asgjë nuk është e pamundur

HASSELT, 24 GUSHT - Këtë sezon piloti holandez i Red Bullit, Max Verstappen, ka fituar tetë nga trembëdhjetë garat e fituara. Ai kryeson renditjen e Formulës 1, duke pasur një avantazh prej 80 pikësh në renditje nga Charles Leclerc me Ferrari. Nëse rikonfirmimi si kampion bote mund të jetë një objektivi i lehtë, pasi i mjafton të dalë gjithnjë i dyti, Verstappen ka në shënjestër një tjetër rekord. Ai synon ta arrijë kuotën e 14 fitoreve sezonale, që do të ishte një rekord. Ky rekorde, me nga 13 fitore brenda një sezoni, mbahet nga dy pilotët gjermanë: Michael Schumacher (2004, me Ferrari) e Sebastian Vettel (2013, me Red Bull). Me 9 gara ende për t'u



zhvilluar, ky rekord nuk është një tabu. Kështu mendon edhe Verstappen: "Gjithçka është e mundur. Unë nuk do të mjaftohem

me administrimin e avantazhit në garat e mbetura, por do ta synoj fitoren kudo. Unë garoj vetëm për fitore", ka thënë Verstappen.

SHKURT

Halimi transferohet në Greqi

Mesfushori i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Besar Halimi, ka nënshkruar me skuadrën nga kategoria e dytë greke, Apollon Smyrnis. Klubi grek e ka zyrtarizuar transferimin e mesfushorit, por nuk ka dhënë detaje për kohëzgjatjen e kontratës. Halimi gjatë karrierës së tij ka luajtur për Mainz, FSV Frankfurt, Brøndby, Sandhausen dhe Stuttgart Kickers.

Evertoni e kërkon me ngulm Brojën

Armando Broja ka përfunduar sërish në listën e dëshirave të skuadrës së Evertonit. Ekipi nga Liverpooli besohet ta ketë kërkuar 20-vjeçarin pjesë e kombëtares kuqezi si pjesë e një shkëmbimi me talentin 21-vjeçar Anthony Gordon, një lojtar krahu që cilësohet si e ardhmja e kombëtares angleze. Edhe pse trajneri i Chelseas, Tuchel, ka nënvizuar mbështetjen për shqiptarin e lindur në Britaninë e Madhe, në tri ndeshje të para të sezonit e ka përdorur shumë pak. Tifozët e Chelseat ndërkohë nuk janë shfaqur aspak të kënaqur nga kjo lëvizje, pasi e cilësojnë sulmuesin shqiptar si një lojtar që mund ta gjejë lehtë golin. Në ditët në vijim priten zhvillime të reja, por nuk përjashtohet mundësia që ta shohim sërish Brojën në huazim te ndonjë klub tjetër në Premierë Ligë.

Nëse Ronaldo largohet, Unitedi e rikthen Depayn

Manchester Unitedi duket se kërkon ta rikthejë Memphis Depay, me holandezin që kërkohet nga bashkëkombësi i tij, Erik Ten Hag. Duket se "Djajtë e Kuq" kërkojnë të përfitojnë nga fakti që Barcelona do të largojë një nga sulmuesit, Depay dhe Pierre-Emerick Aubameyang, duke bërë gati një ofertë prej 8 milionë paundësh për 27-vjeçarin, i cili shihet si zëvendësuesi i Cristiano Ronaldos. Depay prej kohësh është nën radarët e Juventusit, por nëse "Zonja" arrin të transferojë Milik, atëherë holandezi duhet të kërkojë për një skuadër tjetër dhe, siç raporton "Marca", "Old Trafford" mund të jetë destinacioni i ardhshëm i tij, ku u aktivizua edhe në vitet 2015-2017.

Fury kërkon 500 milionë funte për t'u ndeshur me Usykun

Ylli britanik i boksit, Tyson Fury, bënte presion për një duel pa para kundër Anthony Joshuas, për një meç që e quante meç për popullin. Por, raportimet e fundit bëjnë me dije se "Gypsy King" ka kërkuar 500 milionë funte për t'u ndeshur me Oleksandr Usyk. Fury dhe Usyk pritet të përballen në muajin dhjetor, një natë para finales së Kupës së Botës në futboll. Fury ka thënë se nuk pranon oferta të tjera, qoftë edhe një cent më ulët se 500 milionë funte. Mbetet të shihet nëse dueli mes tij dhe Usyk do të mund të aranzhohet.

Realit refuzon 90 milionë euro për Valverden

Realit i Madridit ka refuzuar një ofertë prej 90 milionë eurove për mesfushorin Federico Valverde. Ka qenë gazeta

"Mundo Deportivo" që ka saktësuar se ka qenë një klub nga Premierë Liga që ka trokitur në dyert e Realit për shërbimet

e uruguaiantit, por që ka ndeshur në refuzimin kategorik të kampionëve të Spanjës dhe të Evropës. Nuk dihet se cili ka

qenë klubi i interesuar për mesfushorin e Realit, por besohet se është një ndërmjet Chelseat dhe Manchester

Unitedit. Ky i fundit, jo më larg se të dielën, ka zyrtarizuar transferimin e mesfushorit brazilian të Realit, Casemiro.



Në bazë të dispozitave të nenit 21, parag.21.1 të ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike, respektivisht neni 13 të ligjit 04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L- 087 për ndërmarrjet publike, Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike KRM "Pastrimi" Sh.A. në Prishtinë në mbledhjen e mbajtur me datë 23.08.2022, mori vendim që të shpallë :

K O N K U R S R i s h p a l l j e

Pozita e punës: Sekretar/e Bordit Drejtorve /Këshilltar/e e Përgjithshme

Kohëzgjatja e kontrates: 3 vite

Vendi :Prishtinë

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Mirëmbanë regjistrin e aksionarve të Ndërmarrjes,
- Vepron si agent i Ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve
- Bënë të gjitha arkivimet , publikimet dhe /ose zbulimet për autoritetet përkatëse siq mund të kërkohej me ligj dhe akte nënligjore
- Koordinon me KSHE-ne përgaditjen e shkresave e (dokumenteve) për mbledhjet e Bordit të Drejtorve dhe Komitetit të Auditimit (nëse nuk kërkohej ndryshe nga kryesuesi i tyre), dhe shenon ato në librat e protokoleve, Pranon dhe distribuon shkresat për Bordin e Drejtorëve ,
- Ofron udhëzime juridike për Bordin e Drejtorve
- Përgadite raportet nga rrethveprimi i punëve dhe detyrave dhe
- Kryen edhe punët tjera të kësaj fushe në baze të kërkesës së Bordit të Drejtorve dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes,
- I raporton Bordit të Drejtorve dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Fakulteti Juridik - përgaditja superiore /Diplom universitare
- Të ketë 5 vite përvojë pune në lëmin e fushave juridike në Ndërmarrjet Publike.
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi kompjuterike

Dokumentacion i kërkuar:

- Kandidati duhet të dorëzojë aplikacionin me dokumente në pliko të mbyllura në zyren e arkivës të KRM "Pastrimi"sh.a.rr.Tahir Zajmi"nr.5,Prishtinë dhe duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
- CV, Diplomën e fakultetit, Dëshmin nga trusti pensional Certifikata e lindjes, Kopja e letërnjoftimit, dhe dëshminë se nuk jeni nën hetime jo më të vjetër se 6 muaj,
- Deklaratën nën betim
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato që arrijnë pas afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.

Informata e përgjithshme

- Të drejt aplikim në konkurs kanë të gjithë pa dallim.Ndërmarrja ofron mundësi të barbart, inkujaron dhe promovon angazhimin e punëtorve, pjestar të të gjitha komitetve dhe kandidat pa dallim gjinie.
- Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.
- Konkursi është i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.
- Informata shtesë mund të sigurohen përmes telefonit nr.038/603-191.



Në bazë të dispozitave të nenit 21 parag.21.1,të ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, respektivisht neni13 të ligjit 04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-87 për Ndërmarrjet Publike , Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike KRM"Pastrimi "SH.A Prishtinë në Mbledhjen e mbajtur me datë 23.08.2022 mori këtë vendim që të shpallë;

K O N K U R S R i s h p a l l j e

Pozita e punës ; Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit – (1pozitë).

Kohëzgjatja e kontratës : 3 vite

Vëndi: Prishtinë

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale :

- Të posedojë Diplomë universitare – dhe të ketë provojë profesionale në fushën Financiare dhe Kontabilitet.
- Të dëshmojë përvojën menaxheriale ,udhëheqëse e profesionale nga fusha e kontabilitetit dhe financave ,për së paku pesë(5) vite përvojë drejtuese në Ndërmarrje Publike ,institucione lokale ose qendrore por edhe në Ndërmarrje Private;
- Të njohë programet Softverike të kontabilitetit ,programet operative Mikrosoft Office, (Word,Exel,Outlook etj), të posedojë njohuri dhe shkathtësi për përdorim të kompjuterit ,posaqërisht duhet të ketë njohuri mbi sistemin e avancuar në fushën e financave dhe të kontabilitetit;
- Të plotësoj kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësoj kriteret e pavarisës sipas nenit17.2 pika (d),(f),(j),(k),(l) të Ligjit Nr.03/L-087 të Ndërmarrjeve Publike dhe Plotësim Ndryshimit të LNP nr.04/L-111 neni 13 ;

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore :

- Është përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitave financiare dhe standarteve të kontabilitetit ,ligjet e aplikueshme në Kosovë të cilat rregullojnë çështjet financiare dhe aktet normative të Ndërmarrjes ;
- Organizon,udhëheqë edhe kontrollon punën e Departamentit Financiar ;
- Mbanë përgjegjësin për pagesën e obligimeve financiare në pajtim me rregulloret financiare;
- Mbanë evidencë, ndihmon në hartimin e planëve të investimeve ,Planin e Biznesit dhe dokumentacionet e sakta për investimet dhe pagesat e ndërmarrjes;
- Përcjellë dispozitat financiare në fuqi dhe literaturën profesionale dhe mbanë përgjegjësi nëse nuk aplikohën ligjet në fuqi ;
- Kujdesët për pasurinë e ndërmarrjes, monitoron punën e komisioneve ,kontrollon hyrje – daljet financiare të ndërmarrjes;
- Përgatit llogaritë periodike dhe përfundimtare ;
- Është përgjegjës për përgatitjen e transfereve bankare përkatësisht pagesave me dokumentacione mbështetës dhe siguron KE– në së pagesa është në rregull;
- Harton ,zbaton dhe kontrollon zbatimin e procedurave financiare nga vartësit e tijë;
- Është përgjegjës të kontrollojë mbajtjen në rregull të arkivit të dokumentacionit të Kontabilitetit dhe atijë Financiar ;
- Zhvillon dhe zbaton rregullat e brëndshme të kontrollit si dhe udhëzimet dhe procedurat për aktivitetet si administrimi i buxhetit, menaxhimi i pasurive të detyrimeve edhe mbajtja e llogarive ;
- Është përgjegjës për rregullsitë e procesëve në funksionin e kontabilitetit në kompani,
- përgatitë edhe zbatonë procedurat e kontabilitetit sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të Kompanisë brenda ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme ;
- Përgatit dokumentacionin e ndërmarrjes për auditim dhe ndihmon në mbarvajtjen e procesit të auditimit
- Mbanë përgjegjësi për kryerjen e regjistrimeve dhe barazimeve të pasurisë së Ndërmarrjes ;
- Përgatitë raporte periodike dhe vjetore të Ndërmarrjes për KE-në dhe Bordin e Drejtorëve.
- Ushtron kujdes për ecurinë e shpenzimeve të Ndërmarrjes ,pagesën e obligimeve Ligjore sipas Ligjit të ATK-së dhe afarizmin e Ndërmarrjes;
- ZKFTH I raporton KE-së si dhe Bordit të Drejtorëve.
- Kryen edhe punë tjera ,për të cilat autorizohet nga KE-ja dhe Bordin I Drejtorëve.

Dokumentacioni i kërkuar :

- Kandidati,duhet ta dorëzojë aplikacionin me dokumente në pliko të mbyllur në arkiven e
- KRM Pastrimi "SH.A,Rr.Tahir Zajmi nr,5 Prishtinë.
- Deklaratë nën betim
- CV ,Diplomen e fakultetit ,Dëshmin nga trusti pensional ,Çertifikatën e lindjes ,Kopjen eleternjoftimit ,Dëshmin mbi përvojën e punës, Kandidati së bashku me aplikacionin duhet të dorëzojnë dhe vertetimin nga gjykata kompetente se i njeiti nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- **Dokumentat e pakompletuara si dhe ato që arrijn pas afatit të konkursit , nuk do të shqyrtohen**

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetaret pa dallim .Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta ,inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjestarë të të gjitha komitetve dhe dallim gjinie.
- Konkursi është i hapur **30 ditë** nga dita e publikimit në shtypin ditor .
- Informatat shtesë mund të sigurohen përmes telefonit nr .038/ 603-191



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosovo/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 307/2022 të datës 15 shkurt 2022, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

V A Z H D I M I K O N K U R S I T

I. Administrator i lartë i sigurisë së TI-së

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, një (1) pozitë

Referenca: KPK/SKPK/POZ-011
Emri pozitës: Administrator i lartë i sigurisë së TI-së
Pozita: Pozitë e karrierës
Niveli: Profesional
Raporton tek: Udhëheqësi i Divizionit
Numri i Pozitave: Një (1) pozitë
Koeficienti: Nëntë (9)
Akt emërim: Pa afat
Puna provuese: 12 muaj
Vendi: Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Nën mbikëqyrjen e Udhëheqës i Divizionit Zhvillon, përditëson dhe zbaton politikat dhe procedurat për sigurinë e sistemeve të TI-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Zhvillon, përditëson dhe zbaton politikat dhe procedurat për sigurinë e sistemeve të TI-së;

Menaxhon dhe administron Firewall-at, si dhe pajisjeve tjera të rrjetit sipas nevojës; Instalton, administron dhe mirëmban softuerët dhe harduerët e sigurisë, duke përfshirë, por jo kufizuar, "firewall-ët", IPS (Intrusion Prevention System), SIEM (Security Information and Event Management), antiviruset dhe sisteme tjera sipas nevojës;

Kujdeset për konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e infrastrukturës së TI-së dhe informatave, duke zbatuar praktika të mira;

Mbron sistemet kundër qasjes së paautorizuar, modifikimit dhe/ose shkatërrimit.

Kujdeset për sigurinë dhe mbrojtjen e infrastrukturës komunikuese elektronike dhe të dhënave dhe sipas nevojës, ndihmon institucionet relevante në luftimin e krimit kibernetik (cyber crime);

Kryen monitorime të trafikut të rrjetit, analizon dhe vendosë mekanizmat e sigurisë në sisteme;

Përditëson dhe zbaton protokollet për vazhdimësinë e punës dhe të rimëkëmbjes pas fatkeqësisë;

Propozon projekte të reja për zhvillim, bazuar në nevojat dhe kërkesat e institucionit;

Kryen auditime të sigurisë dhe bën rekomandime të politikave si dhe përgatit raporte në baza periodike;

Kryen detyra të tjera të deleguara nga Udhëheqësi i Divizionit për Infrastrukturë (rrjet dhe server)

Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:

Njohje të punës në Firewall, DNS, DHCP, IDS, IPS, VPN, catalyst, ASA Firewall dhe perimetër router

Njohuri mbi pajisjet kompjuterike të shfrytëzuesve, pajisjet periferike dhe pajisjet ndihmese

Trajnime dhe certifikime në CCNA, CEH apo në ndonjë trajnim tjetër relevant

Njohja e gjuhës angleze;

Shkathsi për punë ekipore;

Shkathsi për hartim të akteve dhe shkresave dhe në komunikim;

Shkathsi për të caktuar synimet më të rëndësishme dhe dhënia e prioriteteve atyre;

Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me te;

Aftësia për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion;

Reagimi i duhur në zgjidhjen e problemeve.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare në shkencat kompjuterike, informatikë dhe të ngjashme.

Përvoja e Punës:

Tri (3) vite përvojë pune në fushën e TI-së.

II. Administrator i lartë i TI-së për Baza të të Dhënave

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, një (1) pozitë

Referenca: KPK/SKPK/POZ-012
Emri pozitës: Administrator i lartë i TI-së për Baza të të Dhënave
Pozita: Pozitë e karrierës
Niveli: Profesional
Raporton tek: Udhëheqësi i Divizionit
Numri i Pozitave: Një (1) pozitë
Koeficienti: Nëntë (9)
Akt emërim: Pa afat
Puna provuese: 12 muaj
Vendi: Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit për Sisteme Elektronike (softuer), Administratori i lartë TI-së për baza të të dhënave është përgjegjës për administrimin e gjitha aplikacioneve në sistemin prokurorial, zhvillim të procedurave për masat e sigurisë së aplikacioneve dhe funksionim të tyre.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Zhvillon dhe implementon aplikacionet/module te reja, sistemet softuerike, dhe/ose përmirësimin e aplikacionit ekzistues në kuadër të SKPK-se;

Instalton, konfigurim dhe administron në mënyrë efektive ueb serverët;

Kryen veprime të përditshme të zhvillimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të sistemeve, duke përfshirë edhe funksionet e administrimit të bazës së shënimeve, konfigurimin dhe përshtatjen/akordimin e performances së aplikacioneve dhe bazave të shënimeve të aplikueshme në sistemin prokurorial;

Siguron mirëmbajtjen dhe mbështetjen teknike për sistemet duke përfshirë përcaktimin dhe korigjimin e problemeve teknike;

Kryen instalimin e sistemeve dhe bazave të shënimeve duke përfshirë instalimin dhe konfigurimin e komponentëve të anës së klientit.

Negocion me mes të përdoruesve të sistemeve dhe bazave të shënimeve dhe ofruesve të jashtëm të shërbimeve në mënyrë që të arrihet një zgjidhje e shpejte e problemeve. Ofron asistencë teknike dhe trajnime për përdoruesit fundor.

Asiston gjatë procesit të përzgjedhjes dhe të analizës të punës së sistemeve apo bazave të shënimeve të reja, ridisenjimin, plotësimin me të dhëna dhe uljen/reduktimin e duplikimit të të dhënave, çështjet e krijimit dhe te integritimit.

Bënë administrimin e ueb aplikacioneve, merret me ngjarjet (events), mbështetjen, kopjet rezerve (back up) dhe rikthimin (recovery) e tyre në funksion;

Kujdeset për të rregulluar punën e regjimit të sigurisë së aplikacioneve, zbulimit eventual të ndërhyrjeve pa leje dhe sanimit që shkaktohen nga këto ndërhyrje në sistemet e TI-së. Përgatit dokumentacionin e sistemit, udhëzimet punuese dhe procedurat standarde të punës në bashkëpunim të ngushtë me palët tjera përkatëse të kyçura;

Të siguroje që procedurat e testimit janë të përcaktuara/definuara, të dokumentuara dhe të zbatueshme.

Analizon dhe vlerëson proceset e punës se rregullt që duhet të kryhet.

Kryen çdo detyrë tjetër që korrespondon ose mund të ndihmojë në kryerjen e funksioneve të administratorit të bazës së të dhënave për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e funksioneve të infrastrukturës se sistemeve. Kryen çdo detyrë tjetër që korrespondon ose mund të ndihmojë në kryerjen e funksioneve të administratorit të bazës së të dhënave për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e funksioneve të infrastrukturës se sistemeve.

Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:

Certifikata për zhvillimin e aplikacioneve në platformën e Microsoft apo te ngjashme – përparësi në programim si në: Java, ASP.Net, C#, VB.Net, XML, Web Services, HTML dhe platforma të tjera të njohura në web;

Të kuptoj dhe mbështes përkthimin e kërkesave funksionale të sistemeve në prokurori ;

Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;

Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare në Inxhinieri Kompjuterike ose Shkenca Kompjuterike.

Përvoja e Punës:

Tri (3) vite përvojë pune në fushën e TI-së.

• Konkursi është vazhduar edhe për 7 (shtatë) ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data 25.08.2022 deri me datë 31.08.2022 si datë e mbylljes së konkursit.

• Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org

• Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.

• Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.

• Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

• Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.

• Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

- Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

- "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."

• Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:

- Dëshminë e kualifikimit shkollor;

- Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi dhe kontrata e punës (Letër Referenca apo Rekomandimi nuk pranohet si dëshmi mbi përvojën e punës);

- Dy rekomandime (nëse ken);

- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);

- Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;

- Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.

• Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin në fuqi.

**Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Na osnovu člana 31 Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona br.03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova i Pravilnika br. 02/2010 o Postupku Zapošljavanja u Civilnoj Službi Kosova, u skladu sa Presudom br. Ref AGJ.1583/20 od 09. jula 2020. godine kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova KPK/br. 307/2022 od 15 februar 2022. godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova objavljuje ovaj:

PRODUŽENJE KONKURSA**I. Viši Administrator IT-a za Bezbednost**

Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, jedna (1) pozicija

Referenca: KPK/SKPK/POZ-011
Naziv pozicije: Viši Administrator IT-a za bezbednost
Pozicija: Pozicija karijere
Nivo: Profesionalni
Izveštava: Šefu Odeljenja
Broj pozicija: Jedna (1) pozicija
Koeficijent: Devet (9)
Akt o imenovanju: Na neodređeno
Probni rad: 12 meseci
Mesto: Priština

Svrha radnog mesta:

Pod nadzorom šefa odeljenja razvija, ažurira i sprovodi politike i procedure za bezbednost IT sistema.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Razvija, ažurira i sprovodi politike i procedure za bezbednost IT sistema;
Upravlja i administrira Firewall, kao i druge mrežne uređaje po potrebi;
Instalira, administrira i održava sigurnosni softver i hardver, uključujući ali ne ograničavajući se na, "firewall", IPS (Intrusion Prevention System), SIEM (Security Information and Event Management), antivirusne i druge sisteme po potrebi;
Vodi računa o poverljivosti, integritetu i dostupnosti IT i informacione infrastrukture, primenjujući dobre prakse;
Štiti sisteme od neovlašćenog pristupa, modifikacije i/ili uništenja.
Brine o bezbednosti i zaštiti elektronske komunikacione infrastrukture i podataka i po potrebi pomaže relevantnim institucijama u borbi protiv sajber kriminala (cyber crime);
Vrši praćenje mrežnog saobraćaja, analizira i primenjuje bezbednosne mehanizme u sistemima;
Ažurira i implementira protokole za kontinuitet rada i oporavak od nepredviđenih događaja;
Predlaže nove razvojne projekte, na osnovu potreba i zahteva institucije;
Vrši bezbednosne revizije i daje preporuke za politike i priprema izveštaje na periodičnoj osnovi;
Obavlja i druge poslove koje delegira šef Odeljenja za infrastrukturu (mreža i server)

Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Poznavanje rada u Firewall, DNS, DHCP, IDS, IPS, VPN, catalyst, ASA Firewall i router perimetar

Poznavanje računarske opreme korisnika, periferne opreme kao i pomoćne opreme
Obuka i sertifikati u CCNA, CEH ili iz neke druge relevantne obuke

Poznavanje engleskog jezika;

Sposobnost rada u timu;

Veštine za izradu akata i dokumenata i u komunikaciji;

Veštine da se postave najvažniji ciljevi i davanje prioriteta istima;

Sposobnost preduzimanja konkretnih inicijativa na poslu i u vezi sa istim;

Sposobnost održavanja kvaliteta rada čak i u uslovima rada pod pritiskom;

Pravilna reakcija u rešavanju problema;

Stručna obuka i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma kompjuterske nauke, informatike i sl.

Radno iskustvo:

Tri (3) godine radnog iskustva u oblasti IT-a.

II. Viši Administrator IT –a za Baze Podataka

Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, jedna (1) pozicija

Referenca: KPK/SKPK/POZ – 012
Naziv pozicije: Viši Administrator IT –a za Baze Podataka
Pozicija: Pozicija od karijere
Funkcionalna kategorija: Profesional
Raportira kod: Rukovodilac Divizije
Broj Pozicija: Jedna (1) pozicija
Koeficijent: Devet (9)
Akt o imenovanju: Na neodređeno
Probni Rad: Dvanaest (12) meseci
Mesto: Priština

Cilj radnog mesta:

Pod nadzorom šefa Odseka za Elektronske Sisteme (softver), Viši Administrator IT-a za Baze Podataka odgovoran je za upravljanje svim aplikacijama u sistemu tužilaca, razvijanje procedura za mere sigurnosti aplikacija i njihovo funkcionisanje.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Razvija i implementira nove aplikacije/module, softverske sisteme i/ili ispravljanje postojeće aplikacije u okviru STSK-a;

Instalira, konfigurira i upravlja veb servere na efektivan način;

Obavlja svakodnevne operacije razvoja sistema, održavanja i upravljanja sistema, uključujući funkcije administracije baze podataka, konfiguraciju i prilagođavanje/akordiranje performanse aplikacija i baze podataka primenljive na tužilačkom sistemu ;

Obezbeđuje održavanje i tehničku podršku za sisteme uključujući određivanje i ispravljanje tehničkih problema;

Obavlja instalaciju sistema i baze podataka uključujući instalaciju i konfiguraciju komponenti za klijente;

Pregovara između korisnika sistema i baze podataka i spoljnih provajdera za usluge kako bi se došlo do brzog rešavanja problema. Pruža tehničku pomoć i obuku za krajnje korisnike.

Pomaže tokom procesa izbora i analize rada novih sistema ili baze novih podataka, redizajniranja, dopunjavanja podataka i smanjenja / reduktovanja dupliranja podataka, pitanja stvaranja i integracije.

Upravlja veb aplikacijama, bavi se događajima, podrškom, rezervnim kopijama (back up) i njihovo ponovno vraćanje u funkciji (recovery);

Pobrine se da uređuje rad režima aplikacijskih sigurnosti, eventualnog otkrivanja neovlašćenih intervencija i saniranja koja se uzrokuju ovim intervencijama u sistemima IT-a. Priprema dokumentaciju sistema, radna uputstva i standardne radne procedure u uskoj saradnji sa ostalim relevantnim strankama koje su uključene;

Obezbediti da procedure testiranja su određene/definisane, dokumentovane i sprovedne.

Analizira i ocenjuje procese redovnog rada koji se treba obavljati.

Obavlja svaki zadatak koji odgovara ili može pomoći u obavljanju funkcija administratora baze podataka kako bi povećao efikasnost i efektivnost funkcija sistemskih infrastrukture.

Znanja, veštine i iskustva za radno mesto:

Sertifikat za razvoj aplikacija na Microsoft platformi ili slično;

Iskustvo u programiranju: Java, ASP.Net, C #, VB.Net, KSMML, Veb usluge, HTML i druge poznate platforme na vebu;

Razumjeti i podržati prevod funkcionalnih zahteva sistema u tužilaštvo;

Veliko znanje u specifičnu stručnu oblast stečeno kroz univerzitetsko obrazovanje i odgovarajuću obuku;

Istraživačke, analitičke, evaluacijske veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta;

Stručna sprema i kvalifikacije:

Univerzitetska Diploma Kompjuterske Inžinjerije ili Kompjuterskih Nauka.

Radno iskustvo:

Tri (3) godine radnog iskustva u oblasti IT-a.

- Konkurs je produžen za 7 (sedam) kalendarski dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dnevnim novinama, počevši od 25.08.2022 do 31.08.2022 kao datum isteka konkursa.
- Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Priština, Kosovo.
- Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.
- Aplikacije poslate putem pošte, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.
- Uslovi učešća na konkursu:
 - Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.
 - Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od svojih osoba muškog i ženskog pola iz redova svojih zajednica na Kosovu.
 - "Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova".
- Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:
 - Svedočanstvo školske spreme;
 - Dokaz o radnom iskustvu; Potvrda i radni ugovor (Referentno pismo ili preporuka se ne prihvataju kao dokaz radnog iskustva).
 - Dve preporuke (ako imate);
 - Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
 - Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;
 - Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavesteni na osnovu važećeg zakonodavstva.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Lirim Elshani shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Fadil Xhurxhehalo shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Peizren.
- ▶ Muhamed Thaqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Mustafa Baku " Prizren.
- ▶ Valon Morina shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Gazmend Ramadani nga fshati Baks, komuna e Skenderajt, shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore të lëshuar nga ShFMU "Dëshmorët e Qyqavicës" në Çirez.
- ▶ Bujar Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Bajram Zenuni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI të SH.M Ekonomike "Kadri Kusari".
- ▶ Leonora Kulludra nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari".
- ▶ Ardian Nikollbibaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë, drejtimi teknik i Elektroteknikes.
- ▶ Taulant Ermeni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII, XIII dhe diplomën e SH.M. Ekonomike " Kadri Kusari"
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients [Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

